



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE

08.06.2024

“Zbatimi në praktikë i legjislacionit mbi të drejtën civile, të drejtën penale, legjislacionit tregtar dhe të drejtën e punës në Republikën e Shqipërisë, në masën që këto i interesojnë profesionit të auditimit ligjor të pasqyrave financiare”

ALTERNATIVA (20 x 1 pikë)

1. Zëvendësimi i debitorit me një person tjetër, i cili merr përsipër detyrimin:

- a) Mund të bëhet vetëm me pëlqimin e kreditorit;
- b) Mund të bëhet edhe pa pëlqim të kreditorit;
- c) Mjafton vetëm vullneti i personit që zëvendëson debitorin;
- d) Nevojitet vetëm marëveshje ndërmjet personit që zëvendëson debitorin dhe debitorit të zëvendësuar;
- e) Nuk shkarkon debitorin e zëvendësuar nga detyrimi i tij ndaj kreditorit.

Përgjigja e saktë është alternativa A

2. Fruta të një sendi në kuptimin civil mund të jenë:

- a) Natyrore;
- b) Civile;
- c) Kamata ligjore;
- d) a) dhe b);
- e) a), b) dhe c).

Përgjigja e saktë është alternativa D

3. Cila prej alternativave të mëposhtme është e pasaktë:

- a) Posedimi mund të ushtrohet drejtpërsëdrejti ose nga një person që mban sendin.
- b) Posedimi i paligjshëm është vetëm me keqbesim;
- c) Posedimi i personit jo pronar është vetëm i paligjshëm;

- d) Posedimi është sundimi efektiv i një personi mbi një send dhe mbi të drejtat e tjera reale mbi atë;
- e) b) dhe c).

Përgjigja e saktë është alternativa E

4. Cila nga alternativat më poshtë është e pasaktë?

- a) Preferimi (privilegji) është një e drejtë, të cilën ligji e jep duke patur parasysh shkakun e kredisë;
- b) Midis shumë kredive të preferuara, përparësia në ekzekutim përcaktohet nga ligji, sipas llojit të preferimit;
- c) Kreditë që janë një lloj të preferuara, konkurrojnë ndërmjet tyre në proporcion me shumën e secilës kredi;
- d) Kreditë që caktohen si të preferuara, kanë përparësi nga të gjithë kreditë e tjera;
- e) Kodi Civil, kredive që rrjedhin nga pagat në marrëdhëniet e punës ose të shërbimit dhe detyrimet për ushqim, por jo më shumë se për 12 muaj, i`u jep preferim përkundrejt kredive që rrjedhin nga transaksionet financiare të siguruara me barrë siguroese për çmimin e blerjes së një objekti të veçantë.

Përgjigja e saktë është alternativa E

5. Nxjerrja e sekreteve të shoqërisë nga eksperti kontabël i saj, me përjashtim të rasteve kur e detyron ligji, përbën:

- a) Krim dhe dënohet me burgim gjer në dy vjet;
- b) Krim dhe dënohet me gjobë;
- c) Kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet;
- d) Kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë;
- e) Kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim gjer në dy vjet.

Përgjigja e saktë është alternativa C

6. Persona të Ekspozuar Politikisht, konsiderohen edhe pas largimit nga funksioni për një periudhë prej:

- a) 1 (një) viti;
- b) 2 (dy) vitesh;
- c) 3 (tre) vitesh;
- d) 4 (katër) vitesh;
- e) 5 (pesë) vitesh.

Përgjigja e saktë është alternativa C

7. Detyrimet e parashikuar në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, për masat parandaluese që duhet të ndërmarrin subjektet, përmbushen

nga administratori ose nga një punonjës i autorizuar i subjektit, në rast se numri i punonjësve të subjekteve të përcaktuara në këtë ligj është:

- a) më pak se 3 persona;
- b) më pak se 5 persona;
- c) më pak se 10 persona;
- d) më pak se 20 persona
- e) më pak se 30 persona.

Përgjigja e saktë është alternativa A

8. Cila nga alternativat e mëposhtme është e saktë për kompetencën e Gjykatës së falimentimit?

Gjykata e falimentimit është kompetente për gjykimin e të gjitha çështjeve që lidhen me procedurën e falimentimit dhe që ndikojnë në masën e falimentimit, duke përfshirë edhe:

- a) çdo padi të administratorit në lidhje me pavlefshmërinë e veprimeve juridike të debitorit;
- b) çdo padi në lidhje me përgjegjësinë e administrimit të debitorit;
- c) çdo padi në lidhje me njohjen dhe/ose kundërshtimin e kërkesave të kreditorit;
- d) rastet që gjykata e falimentimit vepron sipas parashikimeve të këtij ligji;
- e) të gjitha alternativat e mësipërme.

Përgjigja e saktë është alternativa E

9. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është e saktë në lidhje me Administratorin e përkohshëm të falimentimit:

- a) garanton sigurinë dhe ruajtjen e pasurisë së debitorit, nëse gjykata nuk i lejon debitorit të disponojë pasurinë e tij;
- b) kryen detyra që gjykata e falimentimit mund t'i urdhërojë;
- c) ka të drejtë të hyjë dhe hetojë në mjediset e debitorit;
- d) ka të drejtë të kontrollojë librat dhe shënimet e debitorit;
- e) është përgjegjës për dëmet, por jo në të njëjtën mënyrë si administratori i falimentimit;

Përgjigja e saktë është alternativa E

10. Çdo kontratë porosie, që i është dhënë debitorit ose që është dhënë nga debitori dhe që i referohet masës së falimentimit, përfundon:

- a) me fillimin e procedurës së falimentimit;
- b) në afatin e caktuar nga palët në kontratë;
- c) në afatin e caktuar nga administrator i falimentimit;
- d) në afatin e caktuar nga administratori mbikëqyrës;
- e) në afatin e caktuar nga administrator i përkohshëm.

Përgjigja e saktë është alternativa A

11. Data e fillimit të pushimeve vjetore i njoftohet punëmarrësit nga punëdhënësi të paktën:

- a) 10 ditë përpara;
- b) 15 ditë përpara;
- c) 20 ditë përpara;
- d) 30 ditë përpara;
- e) 45 ditë përpara.

Përgjigja e saktë është alternativa D

12. Punëmarrësi me fëmijë deri në tre vjeç, ka të drejtë për një pushim të paguar, kur fëmija i tij është i sëmurë, vërtetuar me raport mjekësor

- a) deri në 10 ditë;
- b) deri në 12 ditë;
- c) deri në 15 ditë;
- d) deri në 20 ditë;
- e) deri në 30 ditë;

Përgjigja e saktë është alternativa C

13. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është e saktë?

Numri unik i identifikimit të subjektit është i vlefshëm për:

- a) identifikimin e subjekteve,
- b) qëllimet e regjistrimit në regjistër,
- c) qëllimet e regjistrimit si person i tatueshëm pranë autoriteteve fiskale qendrore e vendore;
- d) pajisjen me leje, licensë apo autorizimin e kërkuar nga ligji;
- e) autoritetet e inspektimit të marrëdhënieve të punës.

Përgjigja e saktë është alternativa D

14. Cili nga pohimet e mëposhtme nuk është i saktë në lidhje me Regjistrin e Pronarëve Përfitues:

- a) Subjektet raportuese kanë detyrimin të ruajnë dhe të mbajnë të dhëna dhe dokumente shoqëruese të duhura, të sakta e të përditësuara, në bazë të të cilave përcaktohen pronarët përfitues të subjektit dhe lloji i kontrollit të pronarëve të tyre përfitues;
- b) Pronarët përfitues të subjekteve raportuese kanë detyrimin t'u japin subjekteve raportuese të gjithë informacionin e nevojshëm për regjistrim;
- c) Përditësimi apo ndryshimi i të dhënave të regjistruara në regjistër bëhet vetëm nga personi i autorizuar për të përfaqësuar subjektin raportues;
- d) Regjistri i Pronarëve Përfitues administrohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit;
- e) Çdo person mund të marrë informacion për të dhënat e regjistruara në regjistër, të cilat nuk janë lirisht të aksesueshme dhe publike, vetëm nëse provon se ka një interes të ligjshëm për marrjen e këtij informacioni.

Përgjigja e saktë është alternativa C

15. Cili nga pohimet e mëposhtme është i gabuar në shoqëritë aksionare:

- a) një aksion i shoqërisë mund të zotërohet nga një apo më shumë persona;
- b) çdo aksion i zakonshëm i jep zotëruesit të tij të drejta vote në raport proporcional me pjesën e kapitalit që përfaqëson aksioni;
- c) aksionet me përparësi mund të emetohen pa të drejta vote;
- d) aksionet me përparësi nuk mund të përfaqësojnë më shumë se 49 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë;
- e) lejohet emetimi i aksioneve, të cilat i japin zotëruesit të tyre më shumë të drejta vote, në raport me pjesën e kapitalit, që aksioni përfaqëson.

Përgjigja e saktë është alternativa E

16. Në një shoqëri aksionare, e qeverisur me sistemin me një nivel, Këshilli administrimit përbëhet nga:

- a) nga 2 deri në 21 anëtarë;
- b) të paktën 5 apo një numër më i madh, por jo më shumë se 21 anëtarë;
- c) të paktën 7 apo një numër më i madh, por jo më shumë se 21 anëtarë;
- d) të paktën 3 apo një numër më i madh, por jo më shumë se 103 anëtarë;
- e) të paktën 3 apo një numër më i madh, por jo më shumë se 21 anëtarë.

Përgjigja e saktë është alternativa E

17. Gjeni alternativën e saktë për pohimin

Në procesin e bashkimit apo ndarjes së një shoqërie ekspertët e pavarur të fushave të ndryshme duhet të hartojnë një raport në të cilin të vlerësojnë nëse raporti i këmbimit të kuotave/aksioneve është i drejtë dhe i arsyeshëm, duke mbajtur parasysh:

- a) për metodën ose metodat e përdorura për të arritur në raportin e propozuar të këmbimit të aksioneve/kuotave;
- b) nëse kjo metodë apo këto metoda janë të përshtatshme për rastin në fjalë, duke treguar vlerat e arritura përmes përdorimit të metodës/metodave dhe të japin një mendim për rëndësinë relative të secilës metodë, për të arritur në vlerën e vendosur;
- c) në rastin e një zmadhimi kapitali, të kryer në kuadër të bashkimit apo ndarjes, me qëllim pagimin e aksionarëve të shoqërive që përthithen apo ndahen, raporti i vlerësimit duhet të përmbajë një përshkrim të hollësishëm të kontributeve në natyrë, si dhe në të duhet të përcaktohen metodat e vlerësimit që janë zbatuar dhe të shprehet nëse vlera e llogaritur sipas kësaj metode i korrespondon të paktën vlerës nominale të aksionit dhe, kur është rasti, edhe primit më të lartë të emetimit të aksionit;
- d) ekspertët kanë të drejtë të marrin nga shoqëritë që bashkohen të gjithë informacionin dhe dokumentet përkatëse;
- e) të gjitha alternativat e mësipërme janë të sakta;

Përgjigja e saktë është alternativa E

18. Gjeni alternativën e saktë:

- a) Ortaku i kufizuar në shoqëritë komandite përgjigjet personalisht ndaj kreditorëve të shoqërisë deri në vlerën e kontributeve të pashlyera
- b) Marrëveshjet ndërmjet ortakëve, që përjashtojnë ortakun e kufizuar nga detyrimi për të shlyer kontributet, apo që shtyjnë afatin e shlyerjes së këtyre kontributeve, prodhojnë efekte ndaj kreditorëve
- c) Ortaku i kufizuar është i detyruar t'i kthejë fitimet, të cilat i ka marrë në mirëbesim, në bazë të pasqyrave financiare, të përgatitura në mirëbesim
- d) Veprimtaria tregtare e shoqërisë komandite administrohet nga një ose më shumë ortakë të kufizuar
- e) Ortaku i kufizuar mund të veprojë si përfaqësues ligjor i shoqërisë komandite.

Përgjigja e saktë është alternativa A

19. Nga fitimi pas tatimit, i realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, duke zbritur shpenzimet, shoqëria duhet të kalojë në rezervën ligjore:

- a) të paktën 10 për qind të kësaj vlere, derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 30 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, apo me një vlerë më të lartë, të përcaktuar në statut;
- b) të paktën 5 për qind të kësaj vlere, derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 20 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë;
- c) të paktën 10 për qind të kësaj vlere vjetore;
- d) të paktën 5 për qind të kësaj vlere, derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 10 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, apo me një vlerë më të lartë, të përcaktuar në statut;
- e) të paktën 6 për qind të kësaj vlere, derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 20 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, apo me një vlerë më të lartë, të përcaktuar në statut.

Përgjigja e saktë është alternativa D

20. Gjeni alternativën e saktë:

- a) Degët janë vende të ushtrimit të veprimtarisë tregtare, por nuk kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë;
- b) Dega vepron vetëm nën emrin e regjistruar të shoqërisë tregtare;
- c) Dega vepron vetëm nën emrin e saj;
- d) Dega vepron nën emrin e regjistruar të shoqërisë tregtare, si dhe nën emrin e saj;
- e) Zyrat e përfaqësimit kanë si qëllim krijimin e të ardhurave.

Përgjigja e saktë është alternativa D

PYETJE ME SHITJELLIM (4 pikë secila pyetje)

1. Cilat janë rastet kur kërkohet vigjilenca e duhur sipas ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit?

Përgjigje:

Në kuptim të nenit 4 të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit subjektet duhet të marrin masat e vigjilencës së duhur ndaj klientit në rastet e mëposhtme:

a) para se të vendosin një marrëdhënie biznesi;

b) kur klienti, në raste të ndryshme nga ato të përcaktuara në shkronjën “a” të kësaj pike, kryen ose kërkon të kryejë:

- një transfertë brenda ose jashtë vendit apo një transaksion në një shumë të barabartë ose më të madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të huaja, për subjektet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “g” të nenit 3 të këtij ligji, si dhe subjektet e tjera që kryejnë shërbime transfertash, këmbimi valutor apo lojëra fati;
- një transaksion me një shumë të barabartë me jo më pak se 1 000 000 (një milion) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja, kryer në një transaksion të vetëm ose në disa transaksionetë lidhura me njëri-tjetrin. Nëse shuma e transaksioneve nuk dihet në kohën e veprimit, identifikimi duhet të kryhet sapo të bëhet e ditur shuma dhe të arrihet pragu i mësipërm;

c) kur ka dyshime për vërtetësinë e të dhënave të identifikimit të marra më parë;

ç) në të gjitha rastet, pavarësisht nga limitet e raportimit, të parashikuara në këtë nen, kur ka dyshime për pastrim parash ose financim të terrorizmit. (neni 4)

2. Si rregullohet përgjegjësia penale, civile ose administrative nga ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit për subjektet dhe personat që nxjerrin sekretin profesional ose bankar?

Përgjigje:

Në kuptim të nenit 14 të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, subjektet ose autoritetet mbikëqyrëse, drejtuesit, zyrtarët ose punonjësit e tyre, të cilët në mirëbesim raportojnë ose japin informacion, në përputhje me dispozitat e këtij ligji pranë autoritetit përgjegjës, janë të përjashtuar nga përgjegjësia penale, civile ose administrative për nxjerrjen e sekretit profesional ose bankar.

3. Kush ka detyrim për të paraqitur kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit në rastin e personave juridikë? Cilat janë pasojat nëse personat përgjegjës nuk paraqesin kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit nëse janë kushtet ligjore?

Përgjigje:

Në rastin e subjekteve juridike, detyrimi për të paraqitur kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit i takon çdo anëtar i të organit drejtues të debitorit. Nëse një kërkesë e tillë nuk është paraqitur bashkërisht nga të gjithë anëtarët e organit drejtues ose të gjithë anëtarët e shoqërisë së thjeshtë, kërkesa do të lejohet nga gjykata e falimentimit nëse shkaqet e parashikuara për fillimin e procedurës së falimentimit janë të mjaftueshme dhe bindëse. Gjykata e falimentimit dëgjon anëtarët e tjerë të organit drejtues dhe anëtarët e shoqërisë së thjeshtë që nuk i janë bashkuar kërkesës, para se të marrë një vendim.

Nëse përfaqësuesit e sipërcituar të debitorit si person juridik nuk paraqesin kërkesën për fillimin e procedurës së falimentimit, ata do të jenë përgjegjës personalisht për të kompensuar kreditorët për dëmet e pësuarat për shkak të mos paraqitjes së kërkesës për fillimin e procedurës së falimentimit brenda afateve ligjore. Gjithashtu, gjykata e falimentimit mund të vendosë edhe sanksion ndaj debitorit ose çdo anëtar i të organit drejtues që nuk plotëson detyrimin për të paraqitur kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit duke i përjashtuar ata nga e drejta e ushtrimit të çdo veprimtarie për një periudhë nga 1 deri në 5 vjet, në varësi të rëndësisë së shkeljes. (Neni 15)

4. Sa lloj administratorësh njih procedura e falimentimit dhe ku dallojnë ata nga njëri-tjetri?

Përgjigje:

Në procedurën e falimentimit dallohen 3 lloje administratorësh:

1. administratori i përkohshëm i falimentimit;
2. administratori mbikëqyrës;
3. administratori i falimentimit.

"Administrator falimentimi" është administratori i caktuar nga gjykata e falimentimit në vendimin për fillimin e procedurës së falimentimit ose pas hapjes së saj kur zëvendëson debitorin në administrimin dhe drejtimin e veprimtarisë. Në këtë rast të gjitha veprimet e administrimit të shoqërisë kryhen nga administratori i falimentimit dhe jo më nga debitorit.

"Administrator i përkohshëm" është administratori, i cili caktohet nga gjykata e falimentimit para fillimit të procedurës së falimentimit dhe kryen funksionin e mbikëqyrjes ose të administratorit të falimentimit.

Nëse gjykata e falimentimit cakton një administrator të përkohshëm falimentimi dhe nuk i lejon debitorit të disponojë pasurinë e tij, e drejta për të administruar dhe disponuar pasurinë e debitorit i jepet administratorit të përkohshëm të falimentimit. Në raste të tilla, administratori i përkohshëm i falimentimit:

- a) garanton sigurinë dhe ruajtjen e pasurisë së debitorit;
- b) vazhdon administrimin e përditshëm të veprimtarisë së debitorit derisa gjykata e falimentimit të vendosë për fillimin e një procedure falimentimi;
- c) kryen, si ekspert, me kërkesë të gjykatës së falimentimit; dhe
- ç) kryen detyra të tjera që gjykata e falimentimit mund të urdhërojë.

Nëse gjykata e falimentimit cakton një administrator të përkohshëm mbikëqyrës pa vendosur ndaj debitorit ndonjë ndalim të përgjithshëm mbi disponimin e pasurisë, gjykata e falimentimit kërkon që

administratori i përkohshëm të kontrollojë veprimet e debitorit dhe t'i raportojë asaj masa të mëtejshme, të cilat mund të konsiderohen të nevojshme për administratorin e falimentimit.

"Administrator mbikëqyrës" është administratori i caktuar nga gjykata e falimentimit me vendimin e fillimit të procedurës së falimentimit ose më pas për mbikëqyrjen e debitorit dhe për autorizimin e akteve të administrimit dhe detyra të tjera. Në këtë rast debitori vijon të administrojë vetë aktivitetin tregtar, duke kërkuar miratimin nga administrator mbikëqyrës për veprimet e përcaktuara në ligj.

5. Kur konsiderohet pa shkaqe të arsyeshme zgjidhja e kontratës së punës nga punëdhënësi?

Përgjigje:

Zgjidhja e kontratës nga punëdhënësi, konsiderohet pa shkaqe të arsyeshme kur kontrata e punës zgjidhet nëse:

- a) punëmarrësi ka pretendime që rrjedhin nga kontrata e punës;
- b) punëmarrësi ka përmbushur një detyrim ligjor;
- c) shkel ndalimin e diskriminimit, sipas përcaktimeve në Kodin e Punës dhe në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi;
- d) për motive që lidhen me ushtrimin nga punëmarrësi, të një të drejte kushtetuese, por që nuk sjell shkeljen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata e punës;
- e) bëhet për motive të anëtarësimit ose jo të punëmarrësit në sindikatë të krijuar në bazë të ligjit ose për shkak të pjesëmarrjes së tij në veprimtari sindikale në bazë të ligjit;
- gj) punëdhënësi nuk përcakton arsyet e zgjidhjes së kontratës, ose arsyet nuk lidhen me shkaqe të tilla si aftësia, sjellja e punëmarrësit ose kërkesat operationale të ndërmarrjes

6. Cilat janë rastet e pezullimit të aplikimit për regjistrim nga QKB-ja?

Përgjigje:

Pezullimi i aplikimit

1. Në rastet kur pas verifikimeve të parashikuara në nenin 54, të ligjit (pra shqyrtimi dhe verifikimi i aplikimit duke shlyer sanksionet administrative e dhëna apo ka regjistrime të pakryera në lidhje me pasqyrat financiare), rezulton se nuk janë përmbushur kushtet për regjistrim, nuk janë paguar tarifat përkatëse të regjistrimit, ka sanksione administrative të papaguara apo nuk janë kryer regjistrimet e kërkuara, sipas nenit 46, QKB-ja pezullon aplikimin dhe e njofton aplikuesin me shkrim për shkakun esaktë të pezullimit, duke i dhënë një afat prej 21 ditësh kalendarike për plotësimin ose ndreqjen e

elementeve që pengojnë regjistrimin. Njoftimi i shkakut të pezullimit bëhet nëpërmjet një formulari elektronik standard të QKB-së.

QKB ka detyrimin që të njoftojë pezullimin e aplikimit dhe arsyet brenda afatit 1 ditor. Në të kundërt aplikimi quhet i pranuar dhe QKB detyrohet të publikojë të dhënat e regjistruara si të miratuara në heshtje.

7. Çfarë është instituti i përjashtimit të ortakut nga shoqëria me përgjegjësi të kufizuar. Në cilat raste mund të zbatohet ky institut dhe çfarë procedure ndiqet?

Përgjigje:

Ortaku i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar mund të përjashtohet nga shoqëria nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.

Vendimi merret nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve me shumicë të thjeshtë në rastet e mëposhtme, por pa u kufizuar në to:

- a) kur ortakut me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
- b) kur ortakut me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
- c) kur ortakut përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose
- ç) kur ortakut me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.

Pasi vendos përjashtimin e ortakut, Asambleja e Përgjithshme i drejtohet me kërkesë gjykatës, e cila shqyrton bazueshmërinë e vendimit. Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin. Nga ana tjetër, ortakut ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.

Ortakut nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortakut ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

8. Cilat janë përgjegjësitë personale të administratorëve dhe ortakëve të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar për shpërndarjet e ndaluara?

Përgjigje:

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;

b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim. Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e mësipërme. Administratorët, të cilët nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, m'përgjigjen personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë. Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur, pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjendje.

USHTRIME

Ushtrimi 1 (6 pikë)

Ilir kërkon një kredi nga Banka X për të financuar zgjerimin e biznesit të tij. Banka kërkon një garanci shtesë për të siguruar kthimin e kredisë dhe Iliri siguron si dorëzanës vëllain e tij Ervini. Ervini nënshkruan një kontratë dorëzanie ku angazhohet të paguajë detyrimet nëse Iliri nuk e shlyen kredinë sipas kushteve të rëna dakord me Bankën.

- a- Çfarë detyrimesh ka Ervini si dorëzanës?
- b- Në çfarë rrethanash mund të kërkojë Banka që Ervini të shlyejë kredinë?
- c- Çfarë mjetesh juridike mund të përdorë Ervini, pasi ai shlyen kredinë në vend të vëllait të tij Ilirit?

Përgjigje:

a- Dorëzania është një nga mjetet për të garantuar/ siguruar përmbushjen/ekzekutimin e detyrimit. Ervini, në cilësinë e dorëzanësit përgjigjet për aq sa detyrohet (detyrimi kryesor) Iliri përkundrejt Bankës X, duke përfshirë edhe pagimin e kamatës, shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vonesa e ekzekutimit dhe të shpenzimeve të tjera të kryera lidhur me kredinë.

b- Banka X, në rast mosshlyerje të detyrimit nga ana e Ilirit, i drejtohet Ervinit, në cilësinë e dorëzanësit, duke i kërkuar përmbushjen/ekzekutimin e detyrimit, duke përfshirë edhe pagimin e kamatës, shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vonesa e ekzekutimit dhe të shpenzimeve të tjera të kryera lidhur me kredinë.

c- Ervini, me përmbushjen e detyrimit përkundrejt Bankës X, ka të drejtë t'i kërkojë Ilirit kthimin e shumës së paguar prej tij. Në rast mosmarrëveshje, Ervini ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës, duke kërkuar gjyqësisht kthimin e shumës së paguar.

Ushtrimi 2 (4 pikë)

Shpendi është anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të një shoqërie të madhe aksionare “Sun Energy” SH.A, e cila operon në sektorin e energjive të rinovueshme. Ai gjithashtu është aksionar i vetëm në një shoqëri tjetër të energjive të rinovueshme, “Solar and Ëind” SH.A.

Duke qenë anëtar i rëndësishëm në Këshillin Mbikëqyrës të shoqërisë “Sun Energy” SH.A., Shpendi përdor ndikimin e tij për të bërë që “Sun Energy” SH.A. të kontraktojë shoqërinë “Solar and Ëind” për një projekt ndërtimi centrali fotovoltai me kapacitet 50 MË, pavarësisht se oferta e “Solar and Ëind” SH.A. nuk është më e mira dhe ka konkurrentë të tjerë me oferta më të ulëta dhe kushte më të favorshme se “Solar and Ëind” SH.A.

- a- A përbëjnë veprimet e Shpendit vepër penale?
- b- Nëse po, për cilën vepër penale do të mbante përgjegjësi Shpendi?

Përgjigje:

a- Veprimet e Shpendit, duke përdorur ndikimin e tij si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë “Sun

Energy” SH.A. për të favorizuar shoqërinë “Solar and Ęind” SH.A. në të cilën ai është aksionar i vetëm dhe ka interesa personale përbëjnë veprë penale.

b- Shpendi do të mbante përgjegjësi për veprën penale të shpërdorimit të kompetencave, të parashikuar nga neni 164 i Kodit Penal. Ky nen, ndër të tjera, parashikon se shpërdorimi i kompetencave nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës për të favorizuar një shoqëri tjetër ku kanë interesa, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet. Këto masa parashikohen pasi shpërdorimi i kompetencave nga anëtari/ anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të cilët kanë funksione kontrolli e mbikëqyrjeje të zbatimit të politikave tregtare të shoqërisë mund të dëmtojë interesat e aksionarëve, të shoqërisë etj.

Ushtrimi 3 (4 pikë)

Kreditori X, pas dështimit në ekzekutimin e një detyrimi në një procedurë të ekzekutimit të detyrueshëm, i drejtohet direkt Gjykatës së falimentimit me kërkesën për fillimin e procedurës së falimentimit. Prova e vetme e paraqitur nga kreditori për gjëndjen e paaftësisë paguese të debitorit Y është procedura e ekzekutimit të detyrueshëm.

A përbën dështimi i procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm provë për Gjykatën e falimentimit për të pranuar kërkesën e Kreditorit X për fillimin e procedurës së falimentimit sipas ligjit për Falimentimin?

A mundet ta kundërshtojë Debitori Y fillimin e procedurës së falimentimit sa më sipër?

Përgjigje:

Në kuptim të nenit 16 të ligjit për falimentimin gjendja e paaftësisë paguese prezumohet në qoftë se kreditori ka dështuar në ekzekutimin e një detyrimi në një procedurë të ekzekutimit të detyrueshëm gjatë periudhës së ekzekutimit vullnetar, sipas parashikimeve të nenit 517, të Kodit të Procedurës Civile. Si rrjedhojë, Kreditorit X i mjafton kjo provë e dështimit të procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm për t’i kërkuar Gjykatës së falimentimit fillimin e procedurës së falimentimit.

Debitori Y, me anë të paraqitjes së provave, mund të kundërshtojë procedurën e falimentimit sa më sipër nëse vërteton se ka aftësi paguese dhe se nuk ka një detyrim të maturuar e të papaguar ndaj kreditorit.

Ushtrimi 4 (4 pikë)

Punëdhënësi X vendos në dispozicion të punëdhënësit Y 5 të punësuar të tij, të cilët kanë dhënë pëlqimin për këtë transferim. Me kryerjen e transferimit punëdhënësi X që ka transferuar punonjësit pretendon që në këtë moment, kontrata e lidhur me të punësuarit nuk ka më fuqi juridike. Punëdhënësi te i cili janë transferuar punëmarrësit, nuk i ka krijuar të njëjtat kushte pune me punonjësit e tjerë të tij që kryejnë të njëjtën punë.

Cili nga punëdhënësit është përgjegjës për pasojat e ardhura për punëmarrësit nga sjellja e punëdhënësit tek i cili janë transferuar të punësuarit? A ka të drejtë punëdhënësi i parë që të pretendojë se kontrata me të punësuarit nuk ka më fuqi juridike?

Përgjigje:

Punëdhënësi X nuk mund të pretendojë që kontrata me të punësuarit nuk ka më fuqi juridike, pasi kur një punëdhënës vë në dispozicion të një punëdhënësi tjetër punëmarrësin e tij, punëdhënësi i parë është i detyruar t'i sigurojë punëmarrësit të njëjtat kushte pune me ato që u ka siguruar punëdhënësi i dytë punëmarrësve të tij që kryejnë të njëjtën punë.

Punëdhënësi, në dispozicion të të cilit është vënë punëmarrësi, ka të njëjtat detyrime kundrejt tij për mbrojtjen e shëndetit, sigurimit dhe higjienës si ndaj punëmarrësve të tjerë të tij.

Të dy punëdhënësit janë përgjegjës për veprimet e kryera nga punëdhënësi te i cili janë transferuar të punësuarit, pasi kur punëdhënësi nuk përmbush detyrimet e tij kundrejt punëmarrësit, të vënë në dispozicion të një punëdhënësi tjetër, ky i fundit përgjigjet si solidar me punëdhënësin e parë për detyrimet kundrejt punëmarrësit.

Ushtrimi 5 (6 pikë)

Shoqëria A SHPK themelohet me ortak të vetëm shoqërinë italiane B s.r.l., e cila zotërohet në 20% të kuotave nga shtetasi C, 30% të kuotave nga shtetasi D, 40% të kuotave nga G dhe 10 % të kuotave nga shoqëria XXX s.r.l.

Të dhënat e cilëve ortakë janë të detyrueshëm të regjistrohen në regjistrin e pronarëve përfitues sipas legjislacionit shqiptar?

Përgjigje:

Për regjistrimin e shoqërisë A SHPK, administratori i saj ka të detyrueshme të regjistrojë në regjistrin e pronarëve përfitues të dhënat e B s.r.l., si dhe të dhënat e ortakëve të B s.r.l., të cilët zotërojnë më shumë se 25% në kapitalin e shoqërisë. Pra, të dhënat e shtetasit D si ortak në 30% të kuotave dhe G si ortak në 40 % të kuotave.

Ushtrimi 6 (6 pikë)

Personi fizik X blen aksione në shoqërinë aksionare Y me anë të një kontrate shitblerjeje. Kontrata e shitblerjes është e hartuar në formë shkresore. Personi fizik nuk lejohet të regjistrojë në regjistrin e posaçëm aksionet e blera pasi kontrata e shitblerjes nuk është e hartuar me akt noterial.

A ka të drejtë shoqëria Y e cila kërkon që kontrata e shitblerjes të jetë e kryer me akt noterial?

Përgjigje:

Kontrata e shitblerjes është një nga mënyrat sesi fitohet pronësia mbi aksionet. Aksionet e të drejtat e

fituara me kontratën e shitblerjes duhet të regjistrohen në regjistrin e posaçëm të aksioneve që mban shoqëria sipas nenit 119 pika 1 e ligjit 9901/2008, i ndryshuar me qëllim që të ushtrohen të drejtat e fituara si aksioner. Sipas ligjit, shoqëria nuk mund të refuzojë të regjistrojë aksionet në regjistër për shkak se akti i shitblerjes nuk është hartuar me akto notarial pasi sipas nenit 117.3 të ligjit 9901/2008, i ndryshuar, noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Po ashtu, Transaksionet në formë elektronike, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008, “Për titujt”, konsiderohen të kryera në formë shkresore në përputhje me parashikimet e këtij neni. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi aksionet nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit a publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

Ushtrimi 7 (6 pikë)

Shoqëria X kalon në likuidim të zakonshëm në gjendje aftësie paguese me vendim asambleje. Cilat janë hapat që duhet të kryhen me qëllim likuidimin korrekt nga ana e likuiduesve të emëruar me vendim asambleje ortakësh?

Përgjigje:

Me vendim asambleje vendoset kalimi në likuidim e cila çon në prishjen e shoqërisë aksionare në gjendjen e aftësisë paguese. Duke qenë se nuk jemi në kushtet e nisjes së një procedure falimentimi atherë, në zbatim të nenit 189 të ligjit 9901/2008, i ndryshuar, jemi përpara hapjes së procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese e cila rregullohet nga pjesa e VI e ligjit në nenet 190-205.

Likuidimi do të jetë i zakonshëm përderisa nuk është shprehur asambleja për me unanimitet se do procedohet në kushtet e likuidimit të thjeshtëzuar dhe nuk janë bërë deklaratat përkatëse sipas nenit 204.

Likuiduesit e emëruar nga asambleja regjistrohen në QKB nga ana e administratorëve të shoqërisë duke deklaruar të dhënat e tyre dhe tagrat. Neni 194.

Likuiduesit hartojnë ftesën për kreditorët dhe i ftojnë të depozitojnë pretendimet e tyre për prishjen e shoqërisë duke e publikuar 2 herë njoftimin me një interval prej 30 ditësh dhe pretendimet duhet të depozitohen brenda 30 ditësh nga njoftimi i fundit. Neni 195.

Likuiduesit administrojnë shoqërinë nga data e emërimit. Neni 196

Ato mbyllim të gjitha veprimtaritë e shoqërisë por edhe mund të kryejë veprime tregtare për mbylljen e veprimeve të papërfunduara. Neni 197

Përgatisin bilancin e gjendjes së shoqërisë në castin e hapjes së likuidimit dhe në castin e mbylljes së procedurave të likuidimit. Neni 198

Kanë detyrimin të mbrojnë kreditorët gjatë procedurave të likuidimit. Neni 199

Kanë detyrimin të harojnë një raport likuidimi, të drejtën të shpërblehen. Likuiduesit mund të shkarkohen. Neni 200

Në përfundim të shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve ato shpërndajnë aktivet e mbetura për ortakët apo aksionarët. Neni 201

Likuidimi përfundon me njoftimin nga ana e likuiduesit te QKB dhe kërkon nga kjo çregjistrimin e shoqërisë. Neni 202

Ushtrimi 8 (6 pikë)

Asambleja e përgjithshme e shoqërisë “AA” SHPK, mbledhet në datë 05.05.2024. Në rendin e ditës është dhe shkarkimi i administratorit të saj, i cili është kërkuar nga shumica e ortakëve. Gjatë votimit, asambleja vendos shkarkimin e administratorit, i cili u votua nga 60%, ndonëse statuti parashikon se

shkarkimi i administratorit duhet me 2/3 e votave. A është i ligjshëm shkarkimi i administratorit nga asambleja e përgjithshme?

Përgjigje:

Shkarkimi i administratorit është i ligjshëm, pasi asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme, ndërsa statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Pavarësisht se statuti ka përcaktuar se shkarkimi i administratorit duhet me 2/3 e votave, duke qënë se ligji e ndalon këtë kufizim në statut, statuti nuk mund të zbatohet.

Ushtrimi 9 (6 pikë)

Arbeni zotëron 1 kuotë që përfaqëson 25% të kapitalit të regjistruar në shoqërinë ABG SHPK. Ai i ka kërkuar vazhdimisht informacion me shkrim mbi veprimtarinë e shoqërisë administratorit të saj Gencit, i cili njëkohësisht është edhe ortakut tjetër i shoqërisë, por Genci ka injoruar kërkesat e tij. A ka detyrim administratori t'i japë informacionin e kërkuar Arbenit? Nëse po, çfarë veprimesh mund të ndërmarrë Arbeni?

Përgjigje:

Secili prej ortakëve të shoqërisë ka të drejtë të kërkojë informacion mbi veprimtarinë e shoqërisë dhe administratori ka detyrim ligjor t'ua vërë në dispozicion këtë informacion. Ky detyrim mund të përmbushet edhe duke e vendosur këtë informacion në faqen e internetit të shoqërisë tregtare dhe duke informuar për këtë personat, të cilët e bëjnë kërkesën. Në të kundërt, këto dokumente duhet të vihen në dispozicion, për shqyrtim, pranë zyrës qendrore të shoqërisë tregtare.

Nëse personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë nuk japin informacionin e kërkuar, ortakët, anëtarët ose aksionarët e interesuar, brenda 30 ditëve pas refuzimit, mund t'i kërkojnë gjykatës kompetente të urdhërojnë përmbaruesit gjyqësorë të ekzekutojnë kërkesën e ortakut apo aksionarit, duke i dorëzuar këtyre të fundit informacionin dhe dokumentet që personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë nuk kanë dhënë. Mosdhënia e informacioneve të kërkuara, sipas këtij neni, brenda 7 ditëve nga data e marrjes dijeni për kërkesën, vlerësohet refuzim.